

URDHËR
Nr. 680, datë 14.7.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË URDHRIN NR. 354, DATË 21.12.2011,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘MBI MBROJTJEN E KAFSHËVE GJATË
TRANSPORTIT’”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 2, të nenit 72, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 354, datë 21.12.2011, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi mbrojtjen e kafshëve gjatë transportit’”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në nenin 2 ndryshohen përkufizimet me përmbajtje si më poshtë:

“d) Pikë Kontrolli Kufitar nënkupton një vend dhe ambientet që i përkasin atij, të përcaktuara nga autoriteti kompetent qendror për kryerjen e kontrolleve zyrtare në pikën e kontrollit kufitar të mbërritjes së parë në territorin e Republikës së Shqipërisë, për çdo ngarkesë të kategorive të kafshëve dhe mallrat që u nënshtrohen kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar.

e) “Autoritet Kompetent” nënkupton:

- Autoriteti Kompetent Qendror ose Autoritetet Kompetente për organizimin e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare;
- Çdo institucion tjetër të cilit i është dhënë kjo përgjegjësi;
- Autoritetet kompetente të shteteve të tjera.

g) Pikë dalje nënkupton një pikë kontrolli kufitar ose çdo vend tjetër të caktuar nga një autoritet kompetent, ku kafshët e transportuara largohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar transportin e kafshëve që nuk kryhet në lidhje me një aktivitet ekonomik dhe për transportin e kafshëve drejtpërdrejt në ose nga klinikat veterinare, sipas këshillës së një veterineri.”

Pas shkronjës “s” shtohet përkufizimi me këtë përmbajtje:

“sh) Veteriner zyrtar nënkupton veterinerin e emëruar nga një autoritet kompetent që është ose jo pjesë e stafit, i kualifikuar në mënyrë të përshtatshme siç duhet për të kryer kontrolle zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare.”

2. Neni 25 *“Inspektimet dhe raportimet vjetore të autoritetit kompetent”*, ndryshon si më poshtë vijon: *Autoriteti Kompetent i paraqet Autoritetit Kompetent Qendror deri më 31 gusht të çdo viti një raport vjetor për vitin e kaluar mbi inspektimet e kryera prej tyre për të verifikuar përputhjen me kërkesat e këtij urdhri. Raporti duhet të shoqërohet nga një analizë e mangësive kryesore të zbuluara dhe një plan veprimi për të adresuar këto mangësi.*

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1.9.2027.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj